

THE SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA

OFFICE OF THE SUPERINTENDENT

440 NORTH BROAD STREET, SUITE 301

PHILADELPHIA, PENNSYLVANIA 19130

EXECUTIVE OFFICES

TELEPHONE (215) 400-4100

FAX (215) 400-4104

I dashur prind dhe kujdestar,

Drejtoria Arsimore e Filadelfias ka hyrë në një fazë shumë kritike të vitit shkollor, ku frekuentimi në vazhdimësi i nxënësve është i rëndësishëm. Për shkollat, është e vështirë që të ruajnë qëndrueshmëri në frekuentimin e rregullt të nxënësve dhe t'i përgatisë ata për testin e standardizuar, nese kemi transferime të nxënësve nga shkolla në shkollë. Për këtë qëllim, me anë të këtij moratoriumi mbi transferimet e nxënësve midis shkollave të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, që është vendosur kohët e fundit, ne kërkojmë mbështetjen dhe bashkëpunimin tuaj. Kjo do të thotë se, transferimet e nxënësve nga një shkollë e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias në tjetren, do të refuzohen fuqimisht nga 11 Mars-3 Mars, për shkollat fillore cikli i ulët dhe i lartë (elementary/middle schools) dhe 11 Mars-24 Maj, për shkollat e mesme. Vetëm transferimet në rrethana ekstreme do të merren parasysh, dhe se secila do të trajtohet sipas rastit.

Komunitetit i shkollës ka filluar administrimin e testeve të detyrueshme shtetërore të standardizuara të quajtura PSSAs (Vlerësimi i Sistemit të Shkollave të Pensilvanisë) në klasat 3-8. Në vazhdim të PSSA, nxënësit e shkollave të mesme do të kryejnë Provimet Keystone, të cilat janë provime të detyrueshme shtetërore në përfundim të lëndës, për të bërë vlerësimin e aftësive të nxënësve në lëndë të ndryshme. Më poshtë, keni një orar të plotë të këtyre datave të testeve:

11-15 Mars	PSSA Writing	Klasat 5-8
18-22 Mars	PSSA Writing Make-Up Testing	Klasat 5-8
8-19 Prill	PSSA Math and Reading	Klasat 3-8
22-26 Prill	PSSA Science	Klasat 4-8
29 Prill-3 Maj	PSSA Make-Up Testing in Math, Reading, and Science	Klasat 3-8
13-24 Maj	Keystone Testing- Algebra I, Biology, and Literature	Klasat 9-12

Këto teste janë jashtëzakonisht të rëndësishme. Rezultatet përdoren për të përcaktuar përparimin e fëmijës suaj në matematikë, lexim, shkrim dhe shkencë. Rezultatet përdoren gjithashtu për të marrë vendime të rëndësishme mbi strategjitë e zbatuara, për të përmirësuar përparimin në mësimet e nxënësve në shkollat tona. Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni drejtorin e shkollës, nese keni ndonjë pyetje.

Ju lutemi, mbajeni parasysh këtë moratorium, ndërsa bëni plane personale dhe familjare, që mund të ndikojnë në frekuentimin ose në caktimin e shkolles për fëmijën. Ju faleminderit për bashkëpunimin në punën përbashkët në përgatitjen dhe administrimin e testeve kryesore për të gjithë nxënësit.

Sinqerisht,



Karyn T. Lynch

Kryetare, Sherbimet Mbeshtetese te Nxenesve